



Pranuar / Dorezuar Pratijmim / Predato Received / Delivery		08.03.2022		viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shënje Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM8HCK	1239/2022		114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.814/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nga: Arben Mehmeti, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Jeton Koca, anëtarë, me Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. nr. 814/2021, të datës 17.09.2021, të parashtruar nga ankuesja

grup ankuesish, me përfaqësues juridik avokat nga Komuna e Prishtinës, me adresë në Aktgjykimit A.nr.2785/2021, të datës 09.02.2022, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative kundër organit të punësimit Instituti Albanologjik i Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 08.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.814/2021, të datës 17.09.2021 të parashtruar nga ankuesit;

A r s y e t i m

Ankuesit

nëpërmjet përfaqësuesit të tyre avokatit më datë 17.09.2021, kanë parashtruar ankesë me nr. protokolli; 4665/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për kompensim të shujtës ditore prej datës 01.01.2015, deri me datën 31.12.2018, sipas Kontratës Kolektive të Kosovës të datës 18/03/2014.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 27.09.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Instituti Albanologjik Kosovës. Më datë 05.10.2021 Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Instituti Albanologjik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 26.10.2021 me numër protokoli 5170/2021, ka njoftuar avokatin Avni M. Leci, se nuk mundë të shqyrton dhe vendos lidhur me ankesën A.nr.814/2021, të datës 17.09.2021, për shkak se Këshilli nuk ka anëtarë, duke e udhëzuar ankuesen që ti drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesja e pakënaqur me njoftimin e datës 26.10.2021, të Këshillit ka hapur konflikt administrativ, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 09.02.2022, ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2785/2021 me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësve, dhe ka anuluar njoftimin e datës 26.10.2021 me nr protokoli 5170/2021, duke e obliguar Këshillin që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën A.nr.814/2021, të datës 17.09.2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 814/2021 të datës 17.09.2021 e parashtruar nga ankuesit në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimi nr.5170 i datës 26.10.2021 i KPMSHCK-së; kërkesa e KPMSHCK-së për përgjigje në ankesë, nr.4775 e datës 20/09/2021 drejtuar udhëheqësit të personelit të Universitetit "Hasan Prishtina"; kërkesa e KPMSHCK-së për përgjigje në ankesë nr.4775 e datës 27/09/2021 drejtuar udhëheqësit të personelit të Institutit Albanologjik në Prishtinë; Aktgjykimi A.nr.2785/2021 i datës 09.02.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative; Kërkesa për kompensim drejtuar Institutit Albanologjik të Kosovës i datës 17.06.2021; kërkesë e ankuesve e datës 19.08.2021 për qasje në aktin administrativ drejtuar Institutit Albanologjik të Kosovës; Autorizimet (për secilin ankues veç e veç) e datës 31.05.2021 për;

Vërtetimi i datës 20/05/2021 nr.189 që dëshmon punësimin në Institutin Albanologjik të Kosovës të ankueses Vërtetimi i datës 20/05/2021 nr.188 që dëshmon punësimin në Institutin Albanologjik të Kosovës të ankuesit Vërtetimi i datës 31/05/2021 nr.129 që dëshmon punësimin në Institutin Albanologjik të Kosovës të ankuesve;

dhe Emaili i datës 17/09/2021 drejtuar KPMSHCK-së, për prova shtesë; Përgjigje në ankesë e datës 05.10.2021, me numër protokoli 4908/2021; Kontratë e punës Nr.02-25/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesen Kontratë e punës e datës 28.02.2012, për ankuesen Aktvendim nr.02-19 i datës 25/07/2019, për ankuesen për ndërprerje të marrëdhënies së punës për shkak të pensionimit; Kontratë e punës nr.02-27/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesen Akt Emërimi i datës 28.02.2012 për ankuesen Kontratë e punës nr.02-39/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesen Akt Emërimi i datës 28.02.2012 për ankuesen



Kontratë e punës nr.02-42/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesin
 punës nr.02-40/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesen
 për ankuesen
 Akt Emërimi i datës 28.02.2012 për ankuesin
 e datës 28.02.2012 për ankuesen
 Kontratë e punës nr.02-67/-2-14 e datës 31.08.2013 për ankuesen
 Emërimi i datës 31.08.2013 për ankuesen
 31.08.2013 për ankuesen
 Kontratë e punës nr.02-2012 e datës 28.02.2012 për ankuesin
 nr.02-39/19 i datës 17.05.2019 për ankuesin
 01.03.2019 për ankuesin

Kontratë e punës nr.02-24/2012 e datës 28.02.2012 për ankuesin
 ;Kontratë e punës nr.02-32/2012
 Akt Emërimi i datës 28.02.2012 për ankuesen
 Akt Emërimi i datës 28.02.2012 për ankuesen
 Akt Emërimi i datës 31.08.2013 për ankuesen
 Kontratë e punës nr.02-11/02 e datës
 Akt Emërimi i datës 31.08.2013 për ankuesen
 ;Aktvendim
 dhe Kontrata e punës nr.02_ e datës

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës **nuk është kompetent** për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.814/2021, të datës 17.09.2021 të parashtruar nga

, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të ankuesve cilët janë të punësuar në Institutin Albanologjik të Kosovës i cili është Institucion i pavarur publik kërkimor-shkencorë, ka konstatuar se ankuesit janë pozita të nëpunësve të shërbimit publik ashtu siç përcaktohet në bazë të dispozitave të nenit 2, paragrafi 4, të Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se; **4. Nëpunësi i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike, Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marrë parasysh konstatimin se ankuesja ka statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, Kolegji konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.814/2021, të datës 17.09.2021 të parashtruar nga ankuesit:**

Bazuar në nenin 64 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, marrëdhënia e punës e nëpunësve të shërbimit publikë i nënshtrohet legjislacionit të punës, kështu që mbi këtë bazë e në kuptim të nenit 24 paragrafi 4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Kolegji udhëzon ankuesit sipas kësaj anekse se Nëpunësi i Shërbimit Publik ka të drejtë të ankohet të punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesës pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda, A.nr.814/2021, datë 08.03.2022

Arben MEHMETI
Kryetar i Kolegjit

REPUBLIC OF KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO
MINISTERS OF KOSOVO - MINISTERS OF KOSOVO
MINISTERS OF KOSOVO - MINISTERS OF KOSOVO